

Donkishotizmi i poezisë

Mbi guximin e të shkruarit poezi në kohën e babëzisë

*Bajram Kosumi**

Poezia e sfidon modernitetin

Të shkruash poezi në kohën e modernitetit është guxim intelektual. Në modernitetin e shekullit XXI. Të shkruash poezi në këtë kohë është ta sfidosh gjithë modernitetin. Mos ndoshta poezia dhe moderniteti janë skajet e dy kulturave të ndryshme? Edhe nëse kjo pyetje është e skajshme, një gjë dihet me siguri: moderniteti dhe poezia janë shumë larg njëra tjetrës. Sidomos moderniteti në Kosovë dhe poezia janë shumë larg njëra tjetrës, por njësoj është edhe gjetiu, sepse Kosova po bëhet vetëm një kopje e egër e gjetitit.

Poezia është e plagosur

Letërsia, në veçanti poezia, është kështjellë e rrethuar, në muret e së cilës hedhin zjarr e gurë, shigjeta e shtiza..., në të vërtetë, hedhjet nuk janë armë të vërteta mesjetare, por janë armë cinike e përqeshëse: përbuzje si shigjeta, nënçmime si gurë gopedre, cinizëm si zjarri, përqeshje si helmimi i ujit. Përfundimisht, letërsia është shumë e plagosur.

Ajo ka tri plagë të rënda nga sulmet e gjithanshme: nga kulti për paranë, nga jeta virtuale dhe nga vetë letërsia.

* Prof. Assoc. Dr. Bajram Kosumi, rektor i Universitetit Publik të Gjilanit

Kulti për paranë, i shprehur aq mirë në mitin për një dollarëshin amerikan, ia nënshtron vetes çdo vlerë tjetër, duke krijuar një hierarki të re: gjithçka që është më larg parasë është rrjedhimisht më e pavlerë. Kulti për paranë në Kosovë merr forma groteske: babëzi për të përllarë gjithçka para vetes, deri edhe vetë tokën që na mban e na ushqen. Në këtë babëzi letërsia veç prishë punë.

Sepse, letërsia është komunikim njerëzor dhe jo para.

Jeta virtuale po i bën njerëzit gjithnjë e më të pakënaqur, më të hidhëruar me të gjithë, më të dëshpëruar e më të etur për gjithçka, projektues të fushatave të ndërdisjshme për pushtime të mbarë njerëzimit.

Mirëpo, letërsia është komunikim njerëzor dhe jo armë për dominim.

Më në fund, letërsia është e rrezikuar nga vetvetja, nën trysninë e manireve për të shpikur letërsi që ikën nga letërsia, letërsi që nuk komunikon me njeriun dhe lexuesi nuk gjen ide me të cilat mund të komunikojë në letërsi.

Si rrjedhojë, gjithnjë e më të pakët janë ata që kanë luksin të lexojnë.

Cvetan Todorov: rreziku për letërsinë

Cvetan Todorovi, njëri prej mendjeve më të mëdha të letërsisë në shekullin XX, kontribuues i madh që letërsia të futet në këtë rrugë ku është sot, në librin e viteve të fundit *Letërsia në rrezik* (2007) alarmon se letërsia është e rrezikuar nga vetvetja, sepse ajo po e humbë idenë mbi të cilën komunikon me lexuesin dhe, po ashtu, kritika letrare e historia e letërsisë janë vënë në shërbim të vetvetes, në vend që ta ndihmojnë lexuesin ta kuptojë letërsinë.

Kështu, letërsia sot është shumë e plagosur.

Poezia ndërkaq është buzë varrit, është viktima parë dhe më e brishta e modernitetit.

Romanet e famshme tradhtare

Mu për këtë arsye e çmoj thellësisht cilindo që e merr guximin të shkruajë poezi. E çmoj, në radhë të parë, për guximin për ta sfiduar modernitetin. Unë personalisht më shumë e çmoj romanin postmodern, por guximi për të shkruar poezinë është shumë më i madh se guximi për të shkruar romanin, sepse romani ka krijuar hapësira të mbijetesës duke u përshtatur me modernitetin. Ka plot romane të famshme të modernitetit, të cilat kanë tradhtuar idealet e letërsisë, megjithatë janë të famshëm. ***Kodi i Da Vinçit*** i Dan Brown-it për më pak se dhjetë vjet është shitur në 17 milion ekzemplarë luksi dhe në 6 milion ekzemplarë të lirë. A mund ta marrë me mend dikush që poezia e një poeti modern të shitet në mbi njëzetetë milion ekzemplarë? Duke lavdëruar nominimin e librit me poezi të Jan Wagnerit për Çmimin e Panairit të Lajpcigut (2015) në kundërvënien ndaj romaneve, kritikja letrare gjermane Felicitas von Lovenberg, thotë se “ka mundësi që ky panair do të mbetet në histori” mu për këtë arsye. Megjithatë, ky libër me poezi që mundi romanet, mezi është shitur nja gjashtë mijë kopje.

Letërsia CocaCola

Kodi i Da Vinçit ishte top-hit për disa vjet në tregun amerikan dhe europian. Bestseller numër Një. Njoh amvise dhe bujq në Kosovë që e kanë lexuar këtë libër, asi të cilët, ma merr mendja, kurrë nuk kanë dëgjuar për romanin tjetër të fundshekullit XX, ***Emrin e trëndafil*** të Umberto Ekos.

Ndoshta asgjë më mirë se fjala **bestseller** nuk e shënjon këtë letërsi të plagosur. Fjala bestseller i gjykon vlerat letrare dhe të artit në përgjithësi, e në sfond e shprehë se çka i ka bërë artit e letërsisë kulti për paranë. Bestseller do të thotë diçka që shitet më së miri. Për pijet, psh., bestseller është CocaCola. Letërsia në të cilën mbizotërojnë vlerat bestseller është analoge me CocaColën në mbretërinë e saj. Një letërsi-Coca Colë, përfaqësuese e denjë e atij vargu bizar të këngës shqiptare “Edhe e bukur edhe tradhtarë”.

Sigurisht që *Fausti* i Gëtes nuk do të ishte bestseller. Supozoj që Hegeli, një prej mendjeve më të mëdha të historisë së re evropiane, po të konkurronte në tregun bestseller të ideve, do të ishte krejt i pavlerë dhe do të vdiste urie.

Arti ka kuptim vetëm nëse komunikon me njeriun

Për këtë arsye, pasi e lexova *Religjionin e pikëllimit* të Ismail Sylës, pata kënaqësinë të shkruaj pasthënien për poezinë e atij libri, në fund të vitit të kaluar. Poezia e Ismailit e rikthen me siguri të madhe statusin individual e social të poezisë, si art që komunikon me njeriun. Arti, në cilëndo formë, nuk mund të ekzistojë pa komunikim të drejtpërdrejtë e të thellë me njeriun, me mendjen dhe me shpirtin e tij. Përndryshe, do të mbetej vetëm një modë, apo një manir. Në të dy rastet, diçka kalimtare, në zhdukje.

Poezia e Ismail Sylës tregon humnerën shpirtërore

Religjioni i pikëllimit vërteton të kundërtën.

Kjo poezi mund të interpretohet me vetëm një simbol: **tempulli i babëzisë**.

Në tempullin e babëzisë ka uri të pangopshme, babëzi, pikëllim, mospajtim, çuditje, dëshpërim.

Në tempullin e babëzisë:

- njeriu i shëndoshë turpërohet nga shëndeti i tij;
- njeriu i ndershëm turpërohet nga ndershmëria e tij;
- njeriu i drejtë turpërohet nga drejtësia e tij;
- njeriu i bukur turpërohet nga bukuria e tij;
- njeriu që dashuron turpërohet nga dashuria e tij;
- njeriu që derdh djersën në tokën e tij turpërohet nga djersa e tij;
- njeriu që dergj gjakun për tokën e tij turpërohet për gjakun e derdhur...
- ...dhe e kundërta, ai i kundërta i të gjithëve krenohet me babëzinë e tij, krenohet me keqësinë e tij, fryhet e bymehet, e zë hapësirën e vendin, ta zë atdheun, ta ngushton atdheun tënd dhe të prridhë...

Por, gjithmonë ka kryengritës, njerëz që nuk i nënshtrohen së keqes: nuk turpërohen nga shëndeti, nga ndershmëria, nga drejtësia... Po, por janë ata të tjerët, të cilët:

- njeriun e shëndoshë e sëmurin;
- njeriun e ndershëm e turpërojnë;
- njeriun e drejtë e gjykojnë;
- njeriun e bukur e zhbukurojnë;
- njeriun e dashuruar e bishërojnë;
- njeriun që derdh djersën në tokën e tij e korruptojnë;
- njeriun që derdh gjakun për tokën e tij e mohojnë...

Ja, kështu pak a shumë është tempulli i babëzisë së Ismail Sylës.

Kjo poezi na tregon humnerën shpirtërore mbi të cilën po gjëllimë pezull, me rrezikun që në çdo çast të humbim në të.

Në tempullin e babëzisë poezia nuk ofron kurrfarë vlere: me të nuk fitohet pushteti, nuk ndërtohet shtëpia, nuk fitohet fama. Atëherë çfarë vlere na qenka kjo? Poezia është e denjë për përbuzje, për përqeshje.

Katarsisi në art nuk është i tejkaluar kurrë! Nuk ka katarsis, nuk ka art!

Por, në këtë humbëtorë shpirti, poezia e Ismailit më bën të besoj të kundërtën.

Poezia e Ismailit më bën të besoj se fuqia e artit dhe e poezisë ende ndikon në mendjet dhe në shpirtin tonë të hallakatur. Arti nuk na i zgjidhe problemet, por ai na bën të vetëdijshëm për to, na bën esëll për greminën në skajin e së cilës po ecim.

Vargjet programatike të poezisë *Katarsis*:

Spektatorët hyjnë të rënduar,

Kainçe, në shfaqje,

Por dalin të lehtësuar

Me shpirtin Abel.

dëshmojnë fuqishëm misionin social, psikologjik, njerëzor dhe moral të letërsisë, të shprehur që nga antika, përmes katarsisit të Aristotelit, e jashtë të cilit letërsia dhe arti rrezikojnë të zhduken.

Arti na bën më njerëzor dhe, sa herë mëdyshe mi se po vdes letërsia, kundër argumenti më i fortë është pikërisht ky mision i letërsisë dhe përsosmëria e përdorimit të gjuhës sonë. Ne hymjë në teatër kainçe dhe dalim abelçe. Arti na fisnikëron, na zbutë, na qytetëron, sa më shumë mospajtim të artit me jetën e përditshme, aq më shumë ai na qytetëron dhe na bën të vetëdijshëm se si ta perceptojmë jetën, si ta jetojmë jetën dhe si të vdesim. Letërsia nuk është një ushtri armësh, por një ushtri fjalësh të bukura e idesh që na bëjnë të kënaqemi dhe ta pastrojmë veten tonë.

Poezia si anti-delirium

Qysh kur Sokrati e vë në lojë aedin Ijon të Paltoni duke përfunduar se “Poeti është qenie e veçantë: e lehtë, fluturues dhe i shenjtë, dhe nuk mund të këndojë para se të dalldiset, para se të dalë jashtë vetes dhe mendjes së tij të kthjellët...” e deri te romantikët dhe bohemistët, poezia lirike është konsideruar si një delirium, si një gjendje ndryshe nga katarsisi i Aristotelit. Poezia ka shërbyer si një azil për poetët e frymëzuar nga muzat, zanat dhe prej perëndive të tjerë të artit. Atëherë kur njeriu është lodhë e dërmuar nga prozaiteti i realitetit, nga ujqëria dhe babëzia e përditshmërisë, nga urrejtja dhe cinizmi, nga xhelozia dhe smira..., atëherë është fshehur në këshjtjellën e poezisë dhe ka vazhduar aty të jetojë në afshin e frymëzimit, deri sa një ditë i ka prerë venat dhe ka shkruar poezinë e fundit me gjakun e vet.

Por gjithmonë, krahas kësaj poezie, është krijuar edhe poezia si anti-delirium. Poezia e cila, edhe nëse nuk vepron si bar, së pakut të trishton, të tmerron, të ftohë e të alarmon duke të vënë para situatave të papranueshme të jetës. Kjo poezi ta shuan dalldinë. Ajo ta vdes pjesën e zezë. Ajo ta shthurë Mbretërinë Barbare brenda teje.

Moderniteti nuk duhet kuptuar vetëm si shpërfytyrim!

Moderniteti më shumë se asnjë kohë më parë ka shpikur mjaft mënyra, medime e forma për të ikur prej realitetit. Në dekadën e parë të shekullit XXI, pikërisht në mediumin më global të mundshëm, në atë që ka bërë gjithë botën jo një fshat global, jo një metropol global, po thjeshtë një dhomë globale, edhe më tej, një kuti të vogël globale, llaptop, iPad apo mobil, pra pikërisht në kulmin e globalizimit, në facebook, njeriu është më i vetmuar se kurrë, ndërsa jeta e tij virtuale më larg se kurrë

prej jetës së tij reale. Presidenti amerikan Obama, në një çast dëshpërimi dhe homazhi, e pat përdorur shprehjen “ujqër të vetmuar”, duke aluduar në sojin më të ri të njeriut, prodhim i kompjuterizimit e të shkëputur shumë nga realiteti, ëndërrimtarë për pushtimin apo ndryshimin e botës.

Për këtë arsye, e admiroj Ismail Sylën, Merxhanin Avdylin, Visar Zhitin..., apo edhe të vjetrit të cilët na mrekulluan dhe na spastruan me vargje jetike, si Dritëro Agolli..., për guximin për ta shkruar poezinë, kur të gjithë e përqeshin. I falënderoj që na dërgojnë mesazhe trishtuese dhe alarmuese për humnerën shpirtërore të Tempullit të Babëzisë, në të cilin njeriu po lutet që sa kohë.

Kështu, në fund, i nxitur prej interesave krejtësisht pragmatiste dhe jo virtuale, e lus poezinë që të jetojë dhe për aq sa mundet t’ia ofrojë shpirtit tonë të babëzitur një copë akulli.

4 mars 2015